ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI UKSHIN HOTI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **10208-23-9564-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbime të hotelerisë-bufesë në Universitet**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Petra Plast L.L.C.**
NUI	**811857351**
Adresa	**prishitne**
Vendi	**PRISHTINA**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**048226227**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**ISMAJL SADIKI**
Adresa elektronike	**plastpetra233@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**21.03.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbime të hotelerisë-bufesë në Universitet

Njoftimi per kontrate, 31.10.2023

Hapja e ofertave, 22.03.2024

Vlera e pergjitshme, 30,000€

Lloji i procedures, e Hapur

Lloji i kontrates, Sherbime

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Konform nenit 108/A te LPP-se me daten 10.03.2024 kemi dorezuar ne afatin e lejuar ligjor kerkese per rishqyrtim prane Autoritetit Kontraktues, dhe me daten 12.03.2024 kemi pranuar pergjigje nga ana e tyre per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim si te pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat ligjore te Ligjit per Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr.001/2022 per Prokurimin Publik.

Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
Neni 28 - Specifikimet teknike,
Neni 69 - Aftësia teknike dhe/ose Profesionale

Dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik që supozohet të jenë shkelur.

Neni 19 - Specifikimet teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Si palë me interes konform Nenit 4.1.26 të LPP-së pas shkarkimit të dosjes së tenderit konsiderojmë se AK: Universiteti Ukshin Hoti në mënyrë të kundërligjshme ka vendosur kërkesa dhe kritere jo të matshme për aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëcekura.

AK kërkesat e vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit të përshkruara edhe me rregullat përmbajtësore në Aneksin 1 tek Specifikimet teknike të detyrueshme ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik pasi që ka vendosur kritere e kërkesa të cilat në mënyrë direkte e kufizojnë konkurrencën dhe pamundësojn pjesëmarrjen e lirë të operatorëve ekonomik në këtë tender.

Me datën 30.10.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit në platformën e E-prokurimit, duke mos dhënë detaje të mjaftueshme dhe informata të mangëta tek Aneksi 1 - Specifikimet teknike të Detyrueshme ku obligohen të gjithë operatorët ekonomik me kërkesa në kundërshtim me ligjet aktuale në fuqi të Prokurimit Publik. Neni 25.5 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "***Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar***".

Autoriteti Kontraktues me rastin e hartimit të këtyre kërkesave ka rënë në kundërshtim

edhe me ligjet tjera pasi që tejkalon kompetencat e veta si institucion dhe ndërhyn në kompetencat dhe autorizimet e institucioneve tjera relevante si pjesë e kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me kërkesat e vendosura si:

- Certifikata e TVSH-së; kjo kërkesë mendojmë se diskriminon operatorët e rinj ekonomik të cilët funksionojnë si biznese të vogla/individuale që punojnë me termin "3 mujorshi" të cilët nuk kanë fuqi dhe kapacitete për të arritur qarkullimin për tu konsideruar si deklarues i TVSH, natyra e kësaj kontrate i mundëson biznese të vogla të operojnë dhe që të mund ti kryejnë këto shërbime.

Andaj konsiderojmë se një kërkesë e till është në kundërshtim me Nenin 7.2 të LPP-së ku thuhet: "***Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik***".

- Kërkesa tjetër e vendosur si: Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në vlerë prej 40,000€; Informatat e mangëta nga Autoriteti Kontraktues nuk kanë treguar se nëse një biznes i ri, nuk ka referenca të lëshuara nga kompani/biznese private, mirëpo ka të deklaruara shitjet për biznese, a janë të pranueshme librat e shitjes të dorëzuar në ATK si dëshmi të mjaftueshme".

Neni 19.3 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "***Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, përformanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të specifikuara janë obligative apo kërkesa minimale***".

- Kërkesa e AK-së në lidhje me stafin e angazhuar ku ka cekur se duhet të ketë si: menaxher, kuzhinier, kamarier e banakier është në kundërshtim me Nenin 8.5 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, si dhe Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik; Në faqen nr.25 të Udhëzuesit të lartëpërmendur në pikën c) dhe d) në rast të kontratave për ofrimin e shërbimeve ceken se Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin si kërkesë: minimumin e mesatares duke mos kufizuar në numër kërkesën e punëtorëve/personelit që duhet angazhuar. Kjo kërkesë mendojmë se është favorizuese në njërën anë dhe diskriminuese në anën tjetër. Andaj kërkojmë me mirëkuptim kërkesa të ndryshohet kërkesa dhe numri i kufizuar të largohet. Andaj për përdorim të drejtë të fondeve publike konform Nenit 1 dhe Nenit 6 të Ligjit për Prokurimin Pulik besojmë se duhet të largoni kërkesat kufizuese në mënyrë që të keni konkurrencë në këtë aktivitet të prokurimit.

- Kërkesa e AK-së ku ka cekur se operatori ekonomik duhet të posedoj pajisje që nga frigoriferi deri tek tavolinat me karriga druri në hapësirat e ofrimit të shërbimeve; AK nuk ka dhënë informata konform Nenit 28 të LPP-së se ku gjendet kjo hapësirë për ofrimin e shërbimeve, a është pjesë e objektit të Universitetit "Ukshin Hoti", a do të ketë ndonjë

pagesë në emër të qirasë mujore apo duhet të krijohet hapësirë e re nga operatori ekonomik për ofrimin e shërbimeve të bufesë? Neni 44.2 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "Përdorimi i formularëve standard" do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar".

- Aneksi 1 specifikimet teknike janë të mangëta, AK është dashur që neve (operatorëve ekonomik) të na tregon më detajisht lidhur me kërkesat e vendosura tek Aneksi 1 pasi që Specifikimet teknike siq e cekëm nuk janë të kjarta, si dhe kufizimi i çmimeve për klientët privat (studentët) nuk është ligjore nga ana juaj; Kërkesa juaj nuk është ligjore dhe jashta rregullave të prokurimit publik dhe konkurrencës së lirë në treg, për shkak se juve do të ju ofrohen shërbimet që ju i kërkoni për ushqim dhe pije me çmimin e ofertuar mirëpo nuk është ligjore por është ndërhyrje e drejtëpërdrejtëtë dhe imponim material dhe organizativ; kufizohet çmimi i njejtë edhe për klientët privat, pasi që sipas kërkesave tuaja kemi të bëjmë me një investim i cili ka kosto sepse inventari dhe enterieri janë kërkuar 'të reja' dhe mu për këtë ndërhyrja juaj në çmimin e klienturës nuk ka kuptim dhe nuk ka bazë ligjore.

Neni 7.4 i LPP-së thotë: "***Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik***".

- Autoriteti Kontraktues është dashur të na tregon se a do të paguajmë rrymë, ujë (shpenzimet komunalive) gjatë shfrytëzimit të hapësirave në Universitetin 'Ukshin Hoti', kjo ishte dashur të specifikohet në Aneksin 1 të dosjes së tenderit; Ne si operator ekomomik i interesuar nuk kemi informata nëse jemi të liruar ju është dashur ta potenconi, apo nëse do të paguajmë a ka ndonjë paushall apo në bazë të shfrytëzimit të hapësirave të bufesë. Neni 19.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara".

- Kërkesa e AK-së në Aneksin 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme nuk është ligjore, nuk po mundemi ta kuptojm se cili është roli i AK-së me vendosjen e këtij paragrafi "Për çdo shërbim të kryer Ofertuesi i shërbimeve është i obliguar që të lëshojë kuponin fiskal", a mund të na tregoni se sa është kompetencë e AK-së ky paragraf i cituar si më lartë nga ana e Universitetit "Ukshin Hoti"?; këto janë kompetenca direkt të inspektorëve të Administratës Tatimore të Kosovës dhe jo të Universitetit, kjo kërkesë duhet larguar sepse është kufizuese dhe pengon procesin e tenderimit, juve si AK normalisht për secilin shërbim që do të ju ofrohet do të ju shërbehen edhe kuponët fiskal tatimor për shërbimet dhe porositë të cilat do të i pranoni. Kërkesat e vendosura nga AK nuk janë në harmoni as me legjislacionin primar e as sekondar të Ligjit për Prokurimin Publik në lidhje me operatorët e rinj ekonomik të sapo formuar, AK ka vendosur kërkesa diskriminuese. Kërkesat e AK-së nuk janë minimale për kualifikim dhe nuk janë të drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Dispozitat ligjore në vijim si: Neni 25.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi

të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me: a. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe b. përdorim të drejtë të fondeve publike". Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues t'i trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente, duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjor të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Neni 25.6 i Rregullores së Prokurimit Publik thotë: "Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë".

Me çrast kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve tona ankimore në lidhje me shkeljet e supozuara të dispozitave ligjore që janë në fuqi, të nxjerr:

VENDIM

1. **APROVOHET** si e bazuar ankesa jonë në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të hotelerisë-bufesë në Universitet" me nr.10208-23-9564-2-2-1 e inicuar nga Universiteti Ukshin Hoti.

2. **KORRIGJOHET** njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të hotelerisë-bufesë në Universitet" me nr.10208-23-9564-2-2-1 e inicuar nga Universiteti Ukshin Hoti.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deme te konsiderueshme ne pergatitjen e kerkeses per rishqyrtim per arsye te pamundesise se pjesemarrjes ne kete aktivitet te prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*